



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias

Shkrimi krijues

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Objektivi: Shkrimi i një historie për një temë të caktuar, që do të zhvillohet më tej. Shkrimi i një historie për punën e fëmijëve duke përdorur të njëjtën teknikë.



Përfundimi: Përmirësimi i aftësive letrare dhe komunikuese. Është një mjet për të zhvilluar ndjenjat për punën e fëmijëve. Është një mbështetje e mirë për zhvillimin e moduleve të tjera, si të dramatizimit që parashikon shkrimin e një skenari.



Koha

2 orë mësimi së bashku

Motivimi

Është e çuditshme si shprehja letrare është shkatërruar sot nga teknologjia e informatikës. Programet e kompjuterit janë në gjendje të kontrollojnë saktësinë drejtshkrimore, disa gabime gramatikore etj., gjatë shkrimit, duke u lënë hapësirë të vogël njohurive gjuhësore dhe gramatikore që duhet të përvetësojnë fëmijët. Madje, disa programe janë në gjendje të shkruajnë një histori, mjafton që përdoruesi të japë disa fjalë: folje, mbiemra, emra, përemra, ndajfolje. Por në të gjithë këtë nuk ka fare ndonjë gjë argëtuese, as krijmtarisë dhe imagjinatës nuk i mbetet gjë. Të rinjtë duhet të jenë në gjendje të shprehin lirshëm krijmtarinë dhe imagjinatën e tyre.

Disa nga modulet e kësaj pakete mbështeten në artin viziv, por shprehja letrare është shumë e rëndësishme





për zhvillimin e të rinjve. Ata kanë nevojë të pajisen me mjete të caktuara për t'u shprehur. Këto mjete nuk duhet të bëjnë atë që duhet të bëjnë të rinjtë, por thjesht të nxisin aftësitë e tyre të lindura. Me një mbështetje të përshtatshme dhe në një mjedis të përshtatshëm, të rinjtë janë në gjendje të tregojnë një histori për punën e fëmijëve dhe për të gjitha fatkeqësitë që rrjedhin prej saj, në mënyrë që të gjithë bashkëmoshatarët, në të gjithë botën, të kuptojnë këtë dukuri dhe të gjejnë vendin e tyre në të. Nëpërmjet shkrimit, të rinjtë do të jenë në gjendje të përpunojnë një histori, të kërkojnë ndihmë dhe të nxisin bashkëpunimin e të tjerëve.

Së fundi, shkrimi që është rrjedhojë i një eksplorimi të lirë të imagjinatës, është njëkohësisht një mjet çlirues për të rinjtë. Në modulet e tjera u kërkohet të rinjve të shkruajnë këngë, lajmërimi, falenderime, thirrje solidariteti, komunikata të shtypit etj. Ky modul synon të shfrytëzojë forcën e madhe që kanë të rinjtë në fushën e shkrimit, konkretisht të shkrimit krijues. Dëshirojmë që ata të shprehin dëshirat dhe ndjenjat më të fshehta të tyre. Gjëja më e mirë për të arritur këtë, është që të rinjtë të shkruajnë në vetën e tretë, duke treguar një histori, duke u dhënë jetë personazheve, duke mishëruar tek ta atë që ndiejnë me të vërtetë.

Ka shumë të rinj që shkruajnë mirë, në mënyrë krijuese, edhe pse nuk janë të ndërgjegjshëm për këtë. Të marrësh pjesë në shpërthimin e kësaj aftësie, është një përvojë e mrekullueshme.

Në përgjithësi, është e rrallë që të rinjtë të merren me çështje të rëndësishme. Ky modul u jep mundësinë e dyfishtë që, së pari, nëpërmjet shkrimit krijues do të jenë të detyruar të zbulojnë identitetin e vërtetë të vetes. Së dyti, nëpërmjet kësaj veprë letrare, ata do të jenë përgjegjës t'u shpjegojnë bashkëmoshatarëve dhe përfaqësuesve të komuniteteve të tjera, një çështje të një rëndësie globale.

Ky modul i shërben rritjes dhe zhvillimit vetjak të të rinjve dhe forcimit të lidhjes së tyre në përbërje të grupit. Realizimi i këtij moduli do t'ju ndihmojë të vlerësoni karakterin dhe mundësinë e të rinjve të grupit. Do të nxirrni në pah aftësi të tilla, si: autoritetin, komunikimin, ndjeshmërinë. Por mund të jetë dhe një përvojë preke,

pasi do t'ju lejojë që nëpërmjet tregimeve të tyre t'u njihni thellësitë e shpirtit.

Përgatitja

Para se të viheni në punë për të realizuar modulin, duhet ta peshoni mirë nëse do ta zhvilloni vetë apo do të kërkonti edhe një ndihmë të jashtme.

Nëse ndjeheni të sigurtë që mund ta bëni vetë, është mirë të siguroni libra për shkrimin krijues që do të jenë të vlefshme gjatë zhvillimit të modulit. Libra të tillë mund t'i gjeni në bibliotekë.

Për veprimtarinë e parë gjeni një libër të thjeshtë me vjersha për fëmijë. Jepuni kohën e duhur për t'i lexuar këto vjersha dhe mundohuni të zgjidhni ato që tërheqin vëmendjen e fëmijëve.



Shënim për përdoruesin

Ju këshillojmë që për realizimin e këtij moduli, të kërkonti një ndihmë të jashtme. Bëhet fjalë për një modul shumë të rëndësishëm, pasi i pajis të rinjtë me mjete që do t'u mundësojnë të marrin pjesë aktivisht në realizimin e moduleve të tjera që kërkojnë aftësi të shkrimit krijues. Nga ana tjetër, moduli është i rëndësishëm për rritjen vetjake të të rinjve, prandaj ia vlen të bëni një përpjekje për të gjetur ndihmën e duhur nga jashtë.



Nëse njihni një mësues që ka përvojë në shkrimin krijues apo ndonjë person tjetër në komunitet, mos nguroni ta ftoni t'ju ndihmojë. Gjithashtu, mund të shfrytëzoni edhe komunitetin e prindërve, profesionin e tyre, madje mund t'i drejtoheni edhe organizatave të artistëve, nëse ka në qytetin tuaj.

Ndihma e jashtme

Mbi bazën e moshës së anëtarëve të grupit, është mirë të ftoni ndonjë shkrimtar për fëmijë, në mënyrë që të hyjë lehtësisht në komunikim me ta.

Të ftuarit do të jenë në gjendje të ndihmojnë zhvillimin e shprehjes letrare të anëtarëve të grupit, që është një mjet shumë i rëndësishëm në zhvillimin e modulit. Fëmijët mund të jenë të ndrojtur dhe të shprehurit letrar nuk u vjen menjëherë. Ata do të kenë nevojë të ndiehen të mbështetur dhe të nxitur kur përpiqen të shprehin me shkrim emocionet e veta. Të rinjtë nuk e kanë të lehtë t'u hapin shpirtin dhe zëmrën të tjerëve, ata duhet të ndiehen tepër të mbrojtur dhe, mbi të gjitha, të sigurtë që asnjëri nuk do të qeshë me mendimet dhe ndjenjat e tyre.

Mendojmë se falë natyrës së projektit, gjithkush do ta kishte të vështirë t'ju thoshte se nuk mund të bashkëpunojë me ju për këtë modul. Madje mund të llogarisni në koston e realizimit të modulit, edhe një pagesë për artistin apo shkrimtarin që do t'ju afronte ndihmë.

Mund të kërkonte një sponsor për të paguar artistin. Në gjetjen e sponsorit mund të përfshihen edhe të rinjtë e grupit. Përgatisni zërat e buxhetit që ju nevojiten, merrni takim me sponsorët e mundshëm dhe bëjuni të njohur rastin. Në përgjithësi, të rinjtë reagojnë mirë ndaj përgjegjësive që u besohen. Në këtë rast, nëse arrini të gjeni mbështetjen e duhur financiare, përpjekjet e tyre do të shpërbleheshin.

Çfarë duhet

- ✓ Letër, penë, laps
- ✓ Libra me vjersha
- ✓ Dërrasë e zezë ose flipsharter



Zhvillimi i modulit

Strategjia që do të ndiqni varet nga disa faktorë:

- Nëse keni ftuar apo jo një specialist të botës letrare për t'ju ndihmuar;
- Nëse një kolegu juaj ju është afruar për t'ju ndihmuar në realizimin e modulit;
- Nëse keni gjetur libra të mirë në lidhje me shkrimin.



Nëse nuk keni mundur të siguronit kushtet e sipërpërmendura, këshillat që do t'ju japim, mendojmë se janë të vlefshme edhe nëse keni siguruar qoftë edhe njërin prej tyre.

Qëllimi është të nxisni pjesëtarët e grupit të shprehin individualisht. Për realizimin e këtij moduli është mirë që të rinjtë të ndahen në nëngrupe të vogla me 2, 3 ose e shumta 4 veta. Realizimi i ushtrimeve do t'i ndihmojë të rinjtë të fitojnë një besim më të madh në vetëvete, që do t'i ndihmojë më pas në shkrimin e një proze ose tregimi të shkurtër.

Sapo të rinjtë të jenë gati për të punuar individualisht, vendi më i mirë për një gjë të tillë është një klasë ku secili të ketë bankën dhe materialet që i duhen për të punuar. Për të zhvilluar këtë veprimtari, të rinjtë kanë nevojë për hapësirën e duhur.

Organizimi i grupit





Shënim për përdoruesin

Nëse keni siguruar ndihmën e një shkrimtari apo të specialisti, ndoshta metodat që do t'ju përshkruajmë nuk do të kenë vlerë, edhe pse disa prej elementeve të tyre janë të dobishme. Nëse nuk e keni siguruar këtë ndihmë, është e nevojshme që ju të studioni metodat që po ju trajtojmë.

Vargjet dhe metoda e 4 katrorëve mund të realizohen më vete ose njëra pas tjetrës. Kjo varet nga ju dhe koha që keni në dispozicion.

Veprimtaria 1: Vargjet

20 minuta

Një mënyrë e mirë për t'i futur të rinjtë në fushën e shkrimit krijues, bëhet, së pari duke thyer mitin e vështirësisë së të shkruarit. Shumë të rinj mendojnë se mund të shkruajnë, të shumtën, një letër për shokun apo prindërit. Ata as nuk mendojnë të shkruajnë poezi apo vargje të thjeshta.

Për të luftuar këtë pengesë psikologjike, vargjet mund të jenë një mënyrë e shpejtë dhe e këndshme për fillimin e të shkruarit. Leximi me zë të lartë i vargjeve të rimuara krijon një klimë të qetë. Humori i përgjithshëm, pa i detyruar të rinjtë të shprehen, krijon mjedisin e duhur për të përfshirë pa kuptuar grupin. Bisedoni me grupin gjatë leximit të vargjeve. Tërhiqni vëmendjen në fjalët e thjeshta të përdorura dhe natyrshëm kaloni në një poezi humoristike. Në këto momente të rinjtë nuk duhet të trëmben me parashtrimin e rregullave të shkrimit. E rëndësishme është që ata të tërhiqen nga ritmi dhe rima. Duke i mënjanuar të gjitha rregullat, poezia bëhet vetëvetiu më e thjeshtë. Është e natyrshme që nëse të rinjtë duan të kalojnë në poezinë klasike, duhet të zbatojnë rregulla të caktuara, por kjo veprimtaria është thjesht argëtuese.

Pasi të jenë paraqitur një sërë vargjesh, të jenë lexuar disa poezi, është koha që t'u kërkonti të rinjve të krijojnë vargje të gjithë së bashku. Për ta qetësuar atmosferën, shpjegojuni të rinjve se pjesa më e madhe e poezive përbëhet nga strofa me dy ose katër vargje, ku, p.sh., vargu i parë dhe i katërt rimojnë. Në shtesën 1 shpjegohet se çfarë vargu mund të krijojnë dhe si.



Në përfundim të ushtrimit verifikoni si është përvetësuar mekanizmi i krijimit të vargut dhe ftojini të thonë apo të lexojnë vargjet e përgatitura. Kryesisht qëndroni në dyvargshin, se është mënyra më e lehtë. Mund të veproni në dy mënyra:

- Secilit nëngrup kërkojini të zgjedhë fjalën e fundit të vargut të fundit dhe nga kjo fjalë të nisen për të krijuar vargjet.
- I gjithë grupi duhet të përcaktojë fjalën e fundit të vargut të fundit dhe më pas të gjitha nëngrupet duhet të krijojnë vargjet.

Mos u lini shumë kohë në dizpozicion, pasi puna duhet të zhvillohet shpejt. Kaloni nëpër nëngrupet dhe nëse e shikoni të vlefshme, mos nguroni të jepni ndihmën dhe mbështetjen tuaj. Jepni këshilla të përgjithshme dhe vetëm në fund mund të jepni idenë tuaj që mund të futet në varg.

Nëse dëshironi të ruani ritmin e punës, mund të shpërndani dhe çmime:

- Një çmim për grupin që mbaron i pari.
- Një çmim për grupin që ka krijuar vargjet më të mira.


Veprimtaria 2

Metoda e 4 katrorëve

60 minuta

Ka shumë metoda dhe teori për të filluar shkrimin krijues. Një prej tyre është dhe metoda e 4 katrorëve. Bëhet fjalë për një metodë shumë të thjeshtë, mbi bazën e së cilës mund të kalosh në shkrimin e një historie me kërkesa të një niveli artistik më të lartë.

Struktura e metodës së 4 katrorëve paraqitet më poshtë:



Secili katror përmban një pjesë të historisë. Katrori i parë është hyrja, katrorët 2 dhe 3 janë zhvillimi i historisë dhe katrori 4 është mbyllja e historisë. Vetë historia është progresioni nga 1 deri në 4. Edhe në këtë moment është e rëndësishme që të krijoni një klimë qetësie dhe argëtimi në grup. Qëllimi i këtij ushtrimi është të shkruhet një histori në dërrasën e zezë, para se të rinjtë të fillojnë të shkruajnë historinë e tyre.

Duke u përpjekur që historia të jetë sa më e thjeshtë, në katrorin e parë do të paraqitet një personazh (një emër), përshkrimi i personazhit dhe një emocion. Këto 3 pika duhet të shprehen më një fjalë dhe është gjithmonë më mirë të filloni me fjalën që shpreh emocion, p.sh., *trishtim*. Në katrorin e parë shkruani diçka, si, p.sh.: "Historia flet për Tanin (emri i personazhi). Është një elefant (përshkrimi). Është i trishtuar (emocioni). Ky do të jetë fillimi i historisë suaj.

Hapi i mëtejshëm është të shkruash fundin e historisë në katrorin e katërt. Në të duhet të kemi të njëjtin personazh, me të njëjtin përshkrim, por që provon një emocion tjetër, të kundërt me atë të fillimit. Nëse në mënyrë skematike do të plotësonim katrorin e katërt, ai do të përmbajë sa më poshtë: "Historia tregon gjithmonë për Tanin (emri i personazhit). Vazhdon të jetë një elefant (përshkrimi). Po tani është i lumtur (emocioni i kundërt)". Ky është fundi i historisë.

Në katrorët 2 dhe 3 duhet të jepen disa detaje që në mënyrë logjike do të lidhin situatën e katrorit 1 me atë të katrorit 4.

Në katrorin 2 duhet të shkruani deri më 3 motive që e bëjnë elefantin të jetë i trishtuar. P.sh. mund të shkruani që Tani është i trishtuar se nuk ka miq, është i palarë dhe ka uri.

Edhe një herë, për të plotësuar katrorin 3, duhet të nisemi nga e njëjta logjikë, duke u nisur nga tri motivet që e bëjnë elefantin të trishtuar, dhe çfarë mund ta bëjë po këtë elefant të lumtur. Katrori i tretë do të përmbajë 3 motive që e bëjnë tashti elefantin e lumtur. Kërkojini grupit të shkruajë tri motivet që do ta bënin elefantin të lumtur. Përgjigjja e të rinjve mund të jetë: "Tani ka gjetur miq. Nuk vjen më erë. Nuk ka uri". Ose, në përgjithësi tri emocione që janë të kundërta me ato të paraqitura në katrorin 2.

Në katrorin 4 elefanti është i lumtur. Pra keni krijuar një strukturë, të cilën duhet ta mbushni me disa fjalë apo t'i jepni përmbajtje.

Duke shtuar disa detaje, mund të flitet që keni krijuar një histori të vërtetë. Për të bërë këtë, do të përdorni metodën e 6 pyetjeve (kush?, çfarë?, kur?, ku?, pse?, si?). Duke iu përgjegjur këtyre 6 pyetjeve, në të 4 katrorët,

krijuesi do të sigurojë një vijim logjik të historisë, sigurisht duke përdorur edhe gjuhën e përshtatshme. Në këtë mënyrë, mund të shkruhet një histori. P.sh.: Si ka mundur elefanti të gjejë miq të rinj? Cilët janë këta miq? Kush i ka gjetur diçka për të ngrënë? Pse bie erë?

Çdo përgjigje mund të jepet si të duash: e shkurtër apo e gjatë, duke i lënë vend pyetjeve të reja dhe në këtë mënyrë krijohet historia e plotë. Gjithësesi, në dobi të realizimit të ushtrimit është mirë që si fillim kjo histori të jetë e shkurtër dhe e thjeshtë.

Pasi të keni analizuar me grupin mënyrën si funksionon kjo metodë, ndajini të rinjtë në grupe të vogla, caktojuni një temë që ata duhet trajtojnë për një kohë të shkurtër. Ju takon juve të jepni të dhënat e katrorit të parë dhe të katërt. Gjithashtu, ju mund të këshilloni mënyra të ndryshme si mund të trajtohet, që t'i fusni në lojë të rinjtë. P.sh., në katrorin 1 kemi kalin Kuqo që është i trishtuar. Në katrorin e 4 kemi përsëri Kuqon, por që tani është i lumtur. Të rinjtë do të plotësojnë katrorët 2 dhe 3 siç e shpjeguam më sipër, madje ftojini të plotësojnë këtë temë duke përdorur 6 pyetjet.



Lëri të punojnë në grup për 5-10 minuta. Jo më shumë. Rezultati do të jetë më i mirë nëse grupi punon me një farë ritmi. Në përfundim të kohës së caktuar, secili nëngrup do të lexojë historinë që ka krijuar.

Për ta bërë më të gëzueshme seancën, si dhe për të përsheptuar ritmin e ushtrimit, thojini grupit që do të zhvillohet një garë ku do të ketë edhe çmime:

- Historia më argëtuese
- Historia më e bukur.

Veprimtaria 3


Historia e një fëmije që punon

1 orë mësimi

Pasi të keni përfunduar pjesën e këndshme të modulit, duke nxitur interesin e të rinjve dhe duke u treguar se nuk është e vështirë të shkruash, do të kaloni në thelbin e tij, në punën e fëmijëve. Mirë është që kjo pjesë e modulit të zhvillohet në një klasë ku secili të ketë një tavolinë, ku mund të shkruajë qetësisht. Në këtë pjesë të modulit, do të ishte mirë që të rinjtë të punojnë individualisht për të shkruar historinë, por, nëse ju e vlerësoni se është në ndihmë të tyre të punojnë në grupe të vogla, ata mund të grupohen. P.sh., nëse një prej fëmijëve nuk e ka të lehtë të shkruajë, atëherë mund të bashkohet me një shok tjetër në mënyrë që gojarisht ai të shprehë mendimin e vet. Verifikoni që në grupin tuaj ka dukuri të tilla, në mënyrë që ndarja në nëngrupe t'i ndihmojë.

Këtë radhë do t'u kërkonti të rinjve që secili prej tyre të krijojë një histori për një fëmijë që punon. Ushtrimi mund të zhvillohet në tri mënyra:

- Secili prej të rinjve do të zgjedhë një emër, moshën dhe emocionin që i përshtatet fëmijës që punon, dhe do t'i vendosë këto në katrorin e parë. Më pas do të plotësojë katrorin e katërt.
- Së bashku me grupin mund të plotësoni informacionin e duhur në katrorin e parë dhe të katërt dhe më pas secili do të plotësojë katrorët dy dhe tre me të njëjtin personazh.
- Të rinjtë mund të zgjedhin të dyja mundësit ose ta shkruajnë vetë historinë nga fillimi deri në fund, ose të ndjekin informacionin e katrorëve të parë dhe të katërt, që është dhënë nga ju së bashku me grupin.



Veçoni faktin që këtë radhë emocionet e shprehura në katrorët e parë dhe të katërt nuk duhet të jenë detyruesisht të kundërta. P.sh., historia mund të fillojë me ndjenjën e trishtimit dhe po kështu të përfundojë. Gjithësesi, realizimi

i këtyre moduleve niset nga qëndrimi që të transmetojnë një mesazh besimi dhe shprese për shoqërinë dhe veçanërisht për fëmijët që punojnë. Kështu, nëse në fillim të historisë, fëmija që punon, për një sërë motivesh, është i trishtuar, në fund të saj, për disa motive të tjera që jepen gjatë zhvillimit të historisë, do të jetë më pak i trishtuar.

Në shtesën 2 jepet rezultati që kërkojmë. Përdoreni këtë shembull si burimin e fundit të ndihmës. Nëse dëshironi që fëmijët të shkruajnë historitë e tyre, lëroni që ato të zhvillohen mbi bazën e imagjinatës që kanë, duke u bazuar në emocionet e tyre. Gjatë punës kaloni nëpër nëngrupe dhe kujtojeni të rinjve që në çdo katror për të shkruar tekstin, duhet t'u përgjigjen të gjashta pyetjeve. Gjithashtu, duke iu përgjigjur pyetjeve që ju do t'u drejtoni, ata do të fillojnë t'i japin jetë historisë së tyre dhe brenda një kohe të shkurtër nuk do të kenë nevojë të përdorin pyetjet, pasi tregimi do të rrjedhë vetë.

Duka kaluar nëpër nëngrupet e të rinjve, do të jeni në gjendje të shikoni kush shkruan me lehtësi dhe kush ka vështirësi. Uluni pranë të rinjve që kanë vështirësi, dhe ndihmohuni duke përcaktur tiparet e personazhit, jetën dhe ndjenjat e tij. Foluni për mjedisin në të cilën ndodhet ky personazh. Ndiurma mund të përmbledhet: bëhet fjalë për një vajzë apo djalë; si u arriti deri në këtë moment; në ç'vend jeton; ç'punë bën etj. Duke u nisur nga këto drejtime të thjeshta, të rinjtë do të fillojnë të bëjnë pyetje të tjera më të veçanta, duke bërë të mundshme të portretizojnë gjithmonë e më mirë personazhin.

Disa shkrimtarë mbrojnë idenë se duhet të futen në thellësi të personazhit për të cilin shkruajnë, të bëhen si një lloj telekamere. Mundohuni të imagjinoni skenën e fillimit të një filmi. Futeni në skenë personazhin dhe me telekamerë përcaktoni të gjitha elementet e rëndësishme për zhvillimin e filmit: vendin ku ndodhet personazhi; ç'pozicioni ka marrë; është ditë apo natë; është në qytet apo në fshat; nëse është errësirë pse është errësirë; nëse personazhi është i mërziur, pse është i mërziur; si shprehet mërza e tij; është duke qarë, qan pa lot; është i lënduar etj. E kështu me radhë.

Kur të rinjtë fillojnë dhe futen në vorbullën e krijimit, sytë e tyre shkëlqejnë nga intensiteti me të cilën zhvillohet procesi i imagjinatës që shprehet në krijimin e skenave e

ndryshme. Kemi të bëjmë me një atmosferë magjike që ia vlen të vëzhgohet në portretin e të rinjve.

Nëse është e nevojshme, jepuni dhe pak kohë, por pa e tepruar, për të përfunduar tregimin.

Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjanuar

- Sigurohuni që të gjithë të marrin pjesë në ushtrim. Gjithashtu, sigurohuni që të gjithë të shkruajnë diçka, pavarësisht sa e detajuar dhe e gjatë është ngjarja.
- Përdorni humorin dhe mos nguroni të bëni shaka me të rinjtë, pasi në këtë mënyrë do të ndihmoni zhvillimin e seancës. Bëhet fjalë për një modul të këndshëm, por dhe shumë të dobishëm për rritjen dhe pjekurinë e fëmijëve. Të rinjtë nuk do ndërgjegjësohen deri në fund se çfarë kanë mësuar në këtë modul përderisa nuk do të kenë rastin ta zbatojnë në praktikë në jetën e tyre të përditshme dhe në jetën shkollore.
- Mos lejoni as kritikën dhe as mburjen për punën e kryer.
- Nxitini të rinjtë të lexojnë me zë të lartë historinë që kanë krijuar në grup, por mos i detyroni të lexojnë historinë që kanë krijuar vetë, nëse nuk dëshirojnë.
- Ruajini të gjitha punimet e përgatitura nga grupi.



Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi

Pjesa përfundimtare e modulit merret me redaktimin e historive rreth figurës së fëmijës që punon. Ky përbën një moment shumë intensiv pune dhe pjesëmarrjeje. Madje mund të jetë dhe stresues. Ndoshta disa prej të rinjve për herë të parë merren me një veprimtari të tillë dhe kanë nevojë që të ndihmohen për t'u shkëputur nga bota e personazhit dhe të rikthehen në realitet.

Krijoni një mjedis të qetë dhe të sigurtë për të rinjtë. Lëri të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe të përshkruajnë deri në detaje atë që kanë ndjerë dhe kanë përjetuar. Nëse dikush kërkon të lexojë historinë që ka krijuar, jepjani këtë mundësi, por ta lexojë i ulur për të qenë më i qetë. Flisni për detajet e të gjitha tregimeve që janë krijuar. Jepjani fjalën të gjithë anëtarëve të grupit, madje nxitini të bëjnë pyetje. Është e rëndësishme të shikosh si dhe pse të rinjtë i japin jetë një personazhi. Madje, mund t'ju japin shumë informacion përsa kanë shkruar. Pas leximit të të gjitha krijimeve, diskutoni sa më shumë të jetë e mundshme.

Mund të ndodhë që disa prej krijimeve të jenë të një cilësie të mirë dhe të tërheqin vëmendjen e grupit. Është shumë e rëndësishme që të gjitha krijimet të analizohen dhe të vlerësohen mbi bazën e vlerës së tyre të vërtetë. Secili krijim është një tregues i asaj që krijuesit e rinj mendojnë në të vërtetë dhe si ata e konceptojnë punën e fëmijëve.

Bisedoni me grupin rreth mundësisë për të botuar krijimet e përgatitura. Vlerësojini me objektivitet mendimet, respektoni dëshirat e të rinjve. Nëse dëshironi që ju të mbeteni zotëruesi i vetëm i krijimeve të tyre, mos i publikoni, por gjithësesi kjo duhet të bëhet me mirëkuptimin e të rinjve.

Nëse krijimi i ndonjërit prej të rinjve të duket veçanërisht i shkruar mirë, pra nëse mendon se i riu ka talent dhe prirje në fushën e krijimit, kërkoji që, po të dëshirojë, ta zhvillojë në mënyrë më të detajuar krijimin e vet. Historia e shkurtër mund të bëhet një tregim më i

gjatë, më i detajuar dhe mund të tërheqë vëmendjen e një komuniteti më të gjerë, duke i ndihmuar promovimit të projektit dhe veprimtarive të saj për punën e fëmijëve.

Shënim për përdoruesin

Gjatë zhvillimit të moduleve, do të vëreni që arti dhe letërsia do të jenë veçanërisht të vlefshme në realizimin e tyre. P.sh., nëse do të vazhdoni me modulën "Dramatizimi", mund të vini në skenë ndonjë prej historive të krijuara nga të rinjtë. Kjo do të ndihmonte që komuniteti të vlerësonte krijimtarinë e të rinjve, imagjinatën dhe përfshirjen aktive të tyre në këtë problem për t'i vlerësuar dhe për t'i mbështetur. Këto histori do t'i ndihmojnë dhe do t'u japin nxitje të reja për dramatizimin, duke krijuar kështu një temë gjithmonë e më të plotë për punën e fëmijëve.



Vlerësimi dhe vazhdimi



Në lidhje me vlerësimin e këtij moduli, duhet të shikoni nëse janë arritur objektivat e caktuar, pra nëse ka krijuar secili një histori ku trajtohet puna e fëmijëve. Cilësia e krijimit varet në masë të ndjeshme nga ai që e ka shkruar, por dhe nga zbatimi me saktësi të kërkesave të modulit dhe nga marrëdhëniet që ju keni krijuar me grupin.

Për sa i përket vazhdimësisë së modulit, së bashku me grupin do të vendosni për botimin e krijimeve, të gjitha ose disa prej tyre. Mund të botohen në gazetën e shkollës, të afishohen në këndin e talenteve të reja në shkollë apo të vendosen në ndonjë vend tjetër. Të gjithë së bashku mendoni si është më e përshtatshme. Ndoshta ndonjë revistë apo gazetë lokale është e interesuar të botojë ndonjë prej tyre. Lidhuni me botuesit dhe vlerësoni këtë mundësi. Të rinjtë që ndiehen të pasigurtë, qetësojini duke u thënë se botimi do të jetë pa emër dhe që autorët do të publikohen vetëm me miratimin e tyre. Mund të ndodhë që këto histori të krijuara mund të jenë shumë interesante për bashkëmoshatarët dhe të rriturit, prandaj krijoni mundësinë që ato të qarkullojnë dhe të lexohen nga të gjithë. Kjo gjë bën pjesë në procesin e ndërgjegjësimit dhe të përfshirjes së komunitetit.

Që të rritet shkalla e vetëvlerësimit të të rinjve për punën që kanë kryer, nxitini të gjejnë vetë botuesit e krijimeve të tyre. Në varësi të vendit ku zhvillohet moduli, të rinjtë mund të vendosin vetë se ku do t'i botojnë, në gazetën e shkollës, në ndonjë gazetë tjetër apo në ndonjë revistë lokale. Botimi do të ishte një tregues i suksesit dhe do të ndikonte në mënyrë të ndjeshme në rëndësinë e zhvillimit të modulit.

Në përfundim të këtij moduli, ju këshillojmë të vazhdoni me një modul tjetër që nxit krijmtarinë e të rinjve, p.sh., realizimi i një fushate mediatike nëpërmjet modulit "Mjetet e komunikimit, shtypi".

Shtesa 1

Ushtrimi për vargjet

Një mënyrë e thjeshtë për të krijuar një vjershë, është krijimi i një strofe me dy vargje, duke përcaktuar se kush do të jetë fjala e fundit e vargut të fundit dhe më pas ta bësh këtë në të kundërtën.

Hipopotami

Në këtë shembull, fjala e fundit e vargut të fundit është *hipopotamja*, një fjalë që nuk ka kuptim, por me të cilën është e thjeshtë të formosh një rimë, që do të jetë diçka humoristike që të ndihmon të formosh vargun. Hipopotamja nuk është tjetër veçse gruaja e hipopotamit. Shkruani fjalën në mes të dërrasës së zezë dhe lini vend përpara dhe mbrapa fjalës, në mënyrë që të shtoni fjalët që do të plotësojnë vargun. Të rinjtë, duke qeshur, do të mendojnë fjalë të përshtatshme që bëjnë rimë me pjesën e fundit të fjalës hipopotamja që është skamja.

Detyra tjetër është të mendoni fjalë që rimojnë me skamja dhe të zgjidhni njërin prej tyre si fjalë të fundit të vargut të parë, sipas rregullit themelor të rimës. Nxiteni grupin të gjejë fjalë dhe formoni një listë me fjalët e dhëna. Mundohuni që gjithçka ta zhvillonin me ritëm dhe në mënyrë të gëzuar. Do të shikoni se të njëjtën gjë do të bëjnë edhe të rinjtë. Kështu, mund të përcaktohet një ndër fjalët me themelore që do të ndihmojë rimën. E shkruani këtë fjalë në fund të vargut të parë.

Tashmë keni dy fjalët e fundit të të dyja vargjeve. Pra, të rinjtë duhet të mbushin fillimet e të dyja vargjeve. Detyra juaj është të nxisni diskutimin për gjetjen e fjalëve të tjera në mënyrë që këto fjalë të krijojnë një farë kuptimi. P.sh., kërkoni grupit se çfarë gjëje mund t'i bëhet një hipopotami. Me të gjitha gjasat, mund të dalë një fjalë e zakonshme apo diçka e tillë. Vazhdoni në këtë drejtim për të përfunduar vargun duke bërë pyetje të tilla, p.sh.: "Kujt i pëlqen të bëj premtime të baltosura?", "Pse?", "Kujt?" etj.

Burri i hipopotames është hipopotami që mund të ketë një emër, p.sh., Pippo l'Ippo. Ky është vetëm një shembull i zgjedhjeve të shumta që ju mund të bëni. Kryesore është që gjithçka të zhvillohet në një klimë të gëzuar dhe në përfundim të krijohet një strofë që të jetë krijim i grupit. Krijimi përfundimtar mund të jetë pak a shumë kështu në gjuhën italiane:

A Pippo l'Ippo, scapava di rado una fangosa promessa¹
Ma sempre la manteneva con la sua Ippopotamessa.

1. Shënim. Origjinali në gjuhën anglishte është :
*Harry the Hippo was found giving lots of sloppy kisses
But the one who got the least of these was his hippopotamissus*

Shtesa 2

Historia e Sulltanës

Historia e mësipërme është krijuar mbi bazën e 4 katrorëve

Katrori 1: Sulltana është 8 vjeçe. Është një fëmijë që punon dhe është e trishtuar.

Katrori 2: Është e trishtuar se e kanë larguar nga familja e vet dhe më pas është braktisur. Është e trishtuar sepse ka plagë dhe është e sëmurë.

Katrori 3: Sulltana mjekohet me kujdes.

Katrori 4. Sulltana kthehet në familjen e vet dhe është e lumtur.

Historia e Sulltanës zhvillohet duke theksuar disa momente të rëndësishme në jetën e saj, si, p.sh., kur e larguan nga familja e vet dhe e detyruan të punonte, kur e liruan dhe e risollën në familje. Duke u bazuar në parimet e 6 pyetjeve, mund të zhvillojë një histori varfërie që mund të ndodhë në çdo vend të varfër ku vajza e vogël, Sulltana, shitet dhe detyrohet të punojë në një fabrikë veshjesh larg fshatit ku jeton familja e saj. E keqtrajtuar nga pronari i fabrikës dhe nga familja ku jeton, një ditë, i bie të fikët dhe plagoset rëndë në makinën ku punonte. Përpiqet të ikë disa herë, madje një herë arriti të shkonte deri në fshatin e vet, por pronari dërgoi një një bandë me një rrez të këqinj që ta kapnin. Këta keqtrajtuat babain dhe nënën e Sulltanës dhe e rimorën vogëlushen. Pasi e kthyhen te pronari, ai e keqtrajtoi deri në atë pikë, sa u vu në diskutim jeta e saj.

Koha kalon dhe vajza e vogël vazhdon të keqtrajtohet dhe të dhunohet. Më në fund, një grup që lufton për të drejtat e njeriut, i cili vepron në atë zonë, mëson se në këtë fabrikë punojnë fëmijë, madje edhe në moshë shumë të vogël. Grupi organizon aksione në fabrika të tilla dhe çliron fëmijët. Një natë, grupi organizoi një aksion pikërisht në fabrikën ku punonte Sulltana. Çlirojnë vajzën dhe 15 fëmijë të tjerë. Më pas i çojnë në spital dhe i kurojnë nga plagët që tashmë ishin bërë kronike dhe vetëm disa javë më vonë, pasi ishin shëruar, i dërgojnë në shtëpitë e tyre.

Pronari i fabrikës dërgohet në gjyq dhe përfundon në burg. Grupi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve e ndihmoi babin e Sulltanës për të zhvilluar një veprimtari private si prodhues frutash, duke siguruar kështu mbajtjen e familjes. Tashmë Sulltana është shëruar plotësisht dhe është e lumtur.